



**Professional** **HEAVY DUTY**

**GWS 1400 C | GWS 1400 | GWS 14-125**

Robert Bosch Power Tools GmbH  
70538 Stuttgart  
GERMANY

[www.bosch-pt.com](http://www.bosch-pt.com)

1 609 92A B9K (2025.09) 0 / 23



1 609 92A B9K







sq Manuali original i përdorimit












**GWS 1400 C**  
**GWS 1400**  
**GWS 14-125**

**E**

# Shqip

## Udhëzime sigurie

### Paralajmërimet të përgjithshme sigurie për veglat elektrike

#### **⚠️** Lexoni të gjitha paralajmërimet e sigurisë, instruksionet, ilustrimet dhe specifikimet e ofruara me këtë

**vegël elektrike.** Mosndjekja e të gjitha instruksioneve të renditura më poshtë mund të rezultojë në goditje elektrike, zjarr dhe/ose plagosje të rëndë.

**Ruani të gjitha paralajmërimet dhe instruksionet për t'iu referuar në të ardhmen.**

Termi "vegël elektrike" në paralajmërimet e referohet veglës elektrike (me kordon) që punon me energji nga rrjeti elektrik ose veglës elektrike (pa kordon) që punon me energji nga bateria.

#### Siguria e vendit të punës

- ▶ **Mbani vendin e punës të pastër dhe të ndriçuar mirë.** Vendet e rremujshme ose të errëta përbëjnë shkak për aksidente.
- ▶ **Mos i përdorni veglat elektrike në atmosfera shpërthyes, si për shembull në prani të lëngjeve, gazeve ose pluhurit të ndezshëm.** Veglat e punës krijojnë shkëndija që mund të ndezin pluhurin ose avujt.
- ▶ **Mbani larg fëmijët dhe kureshtarët gjatë përdorimit të veglës elektrike.** Tërheqja e vëmendjes mund të bëjë që të humbni kontrollin.

#### Siguria elektrike

- ▶ **Spinat e veglave elektrike duhet të përputhen me prizën elektrike. Mos modifikoni kurrë në asnjë mënyrë spinën. Mos përdorni me veglat elektrike spina përshtatëse me tokëzim.** Spinat e pamodifikuara dhe përputhja me prizat zvogëlon rrezikun e goditjes elektrike.
- ▶ **Shmangni kontaktin e trupit me sipërfaqet e tokëzuara, si për shembull tubacionet, radiatorët, sobat dhe frigoriferët.** Ekziston një rrezik i shtuar i goditjes elektrike nëse trupi juaj është i tokëzuar.
- ▶ **Mos i ekspozoni veglat elektrike në shi ose kushte të lagështa.** Uji që hyn në një vegël elektrike do të rritë rrezikun për goditje elektrike.
- ▶ **Mos e keqpërdorni kordonin. Mos e përdorni kurrë kordonin për të mbajtur, për të tërhequr ose për të shkëputur veglën elektrike nga priza. Mbajeni kordonin larg nxehtësisë, vajit, cepave të mprehtë ose pjesëve lëvizëse.** Kordonët e dëmtuar ose të ngatërruar rritin rrezikun për goditje elektrike.
- ▶ **Kur përdorni veglën elektrike jashtë, përdorni një kablo zgjatuese të përshtatshme për përdorim në ambient të jashtëm.** Përdorimi i një kabloje zgjatuese të përshtatshme për përdorim në ambient të jashtëm zvogëlon rrezikun për goditje elektrike.

- ▶ **Nëse përdorimi i një vegle elektrike në një vend të lagësht është i pashmangshëm, përdorni një linjë furnizimi të mbrojtur me pajisje të rrymës së mbetur (RCD).** Kur përdoret një RCD zvogëlohet rreziku për goditje elektrike.

#### Siguria e personit

- ▶ **Qëndroni vigjilent, shikoni çfarë po bëni dhe përdorni logjikën e zakonshme kur përdorni një vegël elektrike.** Mos përdorni vegël elektrike nëse jeni të lodhur apo nën ndikimin e drogës, alkoolit apo të ilaçeve. Një moment pakujdesie gjatë përdorimit të veglave elektrike mund të rezultojë në plagosje të rëndë të personit.
  - ▶ **Përdorni pajisje mbrojtëse personale. Vendosni gjithmonë mbrojtje për sytë.** Pajisjet mbrojtëse, të tilla si maska kundër pluhurit, këpucët e sigurisë që nuk rrëshqasin, helmata e punës ose mbrojtja e dëgjimit sipas rrethanave të përshtatshme, zvogëlon mundësinë për plagosje të personit.
  - ▶ **Parandaloni ndezjen aksidentale. Sigurohuni që çelësi është në pozicionin fikur përpara se ta lidhni pajisjen me burimin e energjisë dhe/ose baterinë, përpara se ta kapni apo të transportoni veglën.** Mbatja e veglave elektrike me gishtin të çelësi ose ushqimi me energji i veglave elektrike përbën shkak për aksidente.
  - ▶ **Hiqni çdo çelës rregullues ose shtrëngues përpara se të ndizni veglën elektrike.** Çelësi shtrëngues ose rregullues i mbetur në një pjesë rrotulluese të veglës elektrike mund të rezultojë në plagosje të personit.
  - ▶ **Mos u zgjatni shumë. Ruani mbështetjen e duhur me këmbë dhe ekuilibrin në çdo kohë.** Kjo mundëson kontroll më të mirë të veglës elektrike në rrethana të papritura.
  - ▶ **Vishuni si duhet. Mos vishni veshje të gjera ose mos mbani bizhuteri. Mbani flokët dhe veshjet larg nga pjesët rrotulluese.** Veshjet e lira, bizhuteritë ose flokët e gjatë mund të kapen në pjesët rrotulluese.
  - ▶ **Nëse pajisje janë parashikuar me lidhje për thithjen e pluhurit dhe të objekteve mblehdhëse, sigurohuni që këto janë të lidhura dhe përdoren si duhet.** Përdorimi i mblehdhjes së pluhurit mund të zvogëlojë rreziqet që lidhen me pluhurin.
  - ▶ **Mos lejoni që familjariteti i krijuar nga përdorimi i shpeshtë i veglave elektrike t'ju bëjë mospërfillës dhe të nglizhoni parimet e sigurisë së veglave elektrike.** Një veprim i pakujdesshëm mund të shkaktojë plagosje të rëndë në fraksionin e një sekonde.
- #### Përdorimi dhe kujdesi për veglat elektrike
- ▶ **Mos ushtroni forcë mbi veglën elektrike. Përdorni veglën e duhur elektrike për qëllimin tuaj.** Vegla e duhur elektrike do ta kryejë punën më mirë dhe më saktë në shpejtësinë me të cilën është projektuar.
  - ▶ **Mos e përdorni veglën elektrike nëse çelësi nuk ndizet dhe nuk fiket.** Çdo vegël elektrike që nuk mund të komandohet është e rrezikshme dhe duhet riparuar.
  - ▶ **Shkëputni spinën nga burimi i energjisë dhe/ose hiqni baterinë nga vegla elektrike, nëse çmontohet, përpara**

se të kryeni ndonjë rregullim, të ndërroni aksesorët ose përpara se t'i vendosni veglat elektrike në ruajtje. Këto masa parandaluese të sigurisë zvogëlojnë rrezikun e ndezjes aksidentale të veglës elektrike.

- ▶ **Ruani veglat elektrike që nuk i përdorni larg fëmijëve dhe mos lejoni përdorimin e veglës elektrike nga persona që nuk e njohin veglën elektrike ose nuk i dinë këto instruksione.** Veglat elektrike janë të rrezikshme në duart e përdoruesve pa përvojë.
- ▶ **Mirëmbani veglat elektrike dhe aksesorët. Kontrolloni për devijim ose ngjitje të pjesëve lëvizëse, thyerje të pjesëve ose për ndonjë gjendje tjetër që mund të ndikojë në funksionimin e veglës elektrike.** Nëse është dëmtuar, riparoni veglën elektrike përpara përdorimit. Shumë aksidente janë shkaktuar nga mirëmbajtja e dobët e veglave elektrike.
- ▶ **Mbani të pastra dhe të mprehta veglat prerëse.** Veglat prerëse të mirëmbajtura si duhet me tehe të mprehta kanë më pak gjasa të ngecin dhe kontrollohen më lehtë.
- ▶ **Përdorni veglën elektrike, aksesorët dhe majat e veglave etj. në përputhje me këto instruksione, duke marrë parasysh kushtet e punës dhe punën që do të kryhet.** Përdorimi i veglave elektrike për veprime të ndryshme nga ato të parashikuara mund të rezultojë në situatë të rrezikshme.
- ▶ **Mbani të pastra, të thata dhe pa vaj e graso dorezat dhe sipërfaqet e kapjes.** Dorezat dhe sipërfaqet e rrëshqitshme të kapjes nuk mundësojnë manovrimin dhe kontrollin e sigurt të veglës në rrethana të papritura.

### Shërbimi

- ▶ **Kryeni shërbimin e veglës elektrike te një teknik i kualifikuar duke përdorur vetëm pjesë këmbimi identike.** Kjo do të garantojë ruajtjen e sigurisë së veglës elektrike.

### Paralajmërimi sigurie për fresiblën

Paralajmërimi sigurie të zakonshme për punët me lëmim, fërkim, pastrimit me tela ose prerje:

- ▶ **Ky mjet me korrent është bërë që të funksionojë si mjet për lëmues, furçë teli, prerës vrimash ose mjet prerës. Lexoni të gjitha paralajmërimet e sigurisë, instruksionet, ilustrimet dhe specifikimet e ofruara me këtë vegël elektrike.** Mosndjekja e të gjitha instruksioneve të renditura më poshtë mund të rezultojë në goditje elektrike, zjarr dhe/ose plagosje të rëndë.
- ▶ **Me këtë mjet me korrent nuk duhet të bëhen veprime të tilla si, lustrimi.** Veprimet për të cilat ky mjet nuk është krijuar mund të krijojnë rreziqe dhe lëndime fizike.
- ▶ **Mos e konvertoni këtë mjet me korrent që të punojë në një mënyrë për të cilën nuk është krijuar dhe specifikuar nga prodhuesi i mjetit.** Ky lloj konvertimi mund të shkaktojë humbje të kontrollit dhe lëndime fizike.
- ▶ **Mos përdorni aksesorë të cilët nuk janë krijuar specifikisht nga prodhuesi i mjetit.** Vetëm ngaqë një mjet mund të lidhet me këtë mjet me korrent nuk është garanci se do të punojë në mënyrë të sigurt.
- ▶ **Shpejtësia nominale e aksesorit duhet të jetë e paktën e barabartë me shpejtësinë maksimale të shënuar te mjeti me korrent.** Nëse aksesorët punojnë më shpejt se shpejtësia e tyre nominale mund të thyhen dhe të fluturojnë tutje.
- ▶ **Diametri i jashtëm dhe trashësia e aksesorit duhet të jetë brenda kapacitetit të mjetit me korrent.** Aksesorët me përmasë të papërshtatshme nuk mund të mbrohen ose kontrollohen siç duhet.
- ▶ **Përmasat e montimit të aksesorit duhet të përputhen me përmasat e pjesës së montimit të mjetit me korrent.** Aksesorët që nuk përputhen me pjesën e montimit të mjetit me korrent do të humbasin ekuilibrin, do të dridhen tepër dhe mund të shkaktojnë humbje të kontrollit.
- ▶ **Mos e përdorni një aksesor nëse është dëmtuar. Para se ta përdorni, kontrolloni aksesorin, si për shembull disqet për të parë nëse kanë ciflosje ose plasaritje, mbushjet për të parë nëse janë ciflosur, grisur ose konsumuar tepër, furçën e telit për të parë nëse kanë tela të liruar ose të këputur.** Nëse mjeti me korrent ose aksesori rrëzohet, kontrollojeni për të parë nëse është dëmtuar ose instaloni një aksesor të padëmtuar. Pasi ta keni kontrolluar dhe të keni instaluar një aksesor, ju dhe personat pranë duhet të qëndroni larg planit të aksesorit rrotullues dhe ta vini mjetin në punë në shpejtësi maksimale pa ngarkesë për një minutë. Normalisht, aksesorët e dëmtuar thyhen gjatë kësaj prove.
- ▶ **Përdorni pajisje mbrojtëse personale. Në varësi të punës, përdorni maskë, mbrojtëse fytyre ose syze sigurie. Sipas nevojës, vendosni maskë për pluhurin, kufje mbrojtëse, doreza dhe përparëse pune që mund t'i ndalojë copëzat e vogla gërryese ose copëzat e materialeve të punës.** Mbrojtëset për sytë duhet të jenë në gjendje të ndalojnë copëzat fluturorese që shkaktohen nga punët e ndryshme. Maska e pluhurit ose respiratori duhet të jetë në gjendje të filtrojë grimcat që gjenerohen nga puna e caktuar. Ekspozimi për kohë të gjatë ndaj zhurmës me intensitet të lartë mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.
- ▶ **Mbajini personat rrotull në një distancë të sigurt nga vendi i punës. Kushdo që futet në zonën e punës duhet të vendosë pajisje personale mbrojtëse.** Fragmentet e materialit të punës ose të një aksesori të thyer mund të fluturojnë dhe të shkaktojnë lëndime fizike edhe më larg vendit ku punohet.
- ▶ **Kapeni mjetin me korrent vetëm nga sipërfaqet e izoluara të kapjes kur bëni ndonjë punë në të cilën aksesori prerës mund të kontaktojë telat e fshehur ose kordonin e vet.** Nëse aksesori prerës bie në kontakt me një tel me korrent, pjesët metalike të ekspozuara të mjetit me korrent mund të marrin korrent dhe t'i shkaktojnë operatorit goditje elektrike.

- ▶ **Pozicionoieni kordonin larg aksesorit që rrotullohet.** Nëse humbni kontrollin, kordoni mund të pritet ose të shkëputet dhe dora ose krahu t'ju tërhiqet tek aksesori rrotullues.
- ▶ **Mos e lini asnjëherë mjetin me korrent derisa aksesori të ketë ndaluar plotësisht.** Aksesori që rrotullohet mund të kapë sipërfaqen dhe të shkaktojë humbjen e kontrollit të mjetit me korrent.
- ▶ **Mos e vini në punë mjetin me korrent ndërkohë që e mbani anash.** Kontakti padashur me aksesoren rrotullues mund t'ju kapë rrobat, duke e tërhequr aksesoren drejt trupit tuaj.
- ▶ **Pastrojini rregullisht hapësirat e ajrimit të mjetit me korrent.** Ventilatori i motorit tërheq pluhur brenda trupit dhe grumbullimi i tepërt i pluhurit të metalit mund të shkaktojë goditje elektrike.
- ▶ **Mos e vini mjetin me korrent në punë pranë materialeve të djegshme.** Shkëndijat mund t'i ndezin këto materiale.
- ▶ **Mos përdorni aksesore që kanë nevojë për ftohës të lëngshëm.** Përdorimi i ujit ose i ftohësve të tjerë të lëngshëm mund të shkaktojë goditje elektrike.

#### Goditjet mbrapsht dhe paralajmërimet përkatëse:

Goditja mbrapsht është një reagim i papritur ndaj kafshimit ose bllokimit të diskut rrotullues, diskut mbështetës, furçës ose të ndonjë aksesori tjetër. Kafshimi ose bllokimi shkakton ndalim të papritur të aksesorit rrotullues, i cili në këmbim bën që mjeti me korrent të shkojë me forcë në mënyrë të pakontrolluar në drejtim të kundërt të rrotullimit të aksesorit të pika e bllokimit.

Për shembull, nëse një disk bllokohet ose kafshohet nga materiali i punës, buza e diskut që futet te pika e kafshimit mund të dalë në sipërfaqe të materialit duke shkaktuar që disku të dalë ose të kërcejë me forcë. Disku ose mund të kërcejë operatorit, ose drejt tij, në varësi të drejtimit të lëvizjes së diskut në pikën e kafshimit. Gjithashtu disqet gërryese mund të thyhen në situata të tilla.

Goditja mbrapsht është pasojë e keqpërdorimit të mjetit dhe/ose e procedurave ose kushteve të gabuara të punimit, e cila mund të shmanget duke marrë masat parandaluese të mëposhtme.

- ▶ **Kapeni fort mjetin me korrent me të dyja duart dhe poziciononi trupin dhe krahët në mënyrë të tillë që t'u rezistoni forcave të goditjes mbrapsht.** Përdorni gjithnjë dorezë ndihmëse, nëse ka, që të kenë kontroll maksimal ndaj goditjeve mbrapsht ose reagimit të forcës rrotulluese gjatë vënies në punë. Operatori mund të kontrollojë forcën e reagimit të rrotullimit ose të goditjes mbrapsht nëse merren masa parandaluese të përshtatshme.
- ▶ **Mos e vendosni asnjëherë dorën pranë aksesorit rrotullues.** Aksesori mund t'ju godasë dorën.
- ▶ **Mos e poziciononi trupin te vendi ku mjeti do të lëvizë nëse ndodh goditja mbrapsht.** Goditja mbrapsht do ta shtyjë mjetin në drejtim të kundërt të lëvizjes së diskut në pikën e bllokimit.

- ▶ **Bëni shumë kujdes kur punoni në cepa, anë të mprehta etj. Shmangni kërcimin dhe rrëshqitjen e aksesorit.** Cepat, anët e mprehta ose kërcimi kanë prirjen që të bllokojnë aksesoren rrotullues dhe të shkaktojnë humbje të kontrollit ose goditje mbrapsht.
- ▶ **Mos vendosni fletë sharrimi motorseke për punim druri, disk diamantit të segmentuar me hapësirë periferike më të madhe se 10 mm ose fletë sharre të dhëmbëzuar.** Këto thika krijojnë goditje mbrapsht të shpeshta dhe humbje të kontrollit.

#### Paralajmërimet sigurie specifike për punët e fërkimit dhe prerjes:

- ▶ **Përdorni vetëm llojet e disqeve që janë specifikuar për mjetin tuaj dhe mbrojtëset specifike për diskun e zgjedhur.** Disqet për të cilat mjeti me korrent nuk është krijuar nuk mund të mbrohen në mënyrë të përshtatshme dhe janë të pasigura.
- ▶ **Sipërfaqja e fërkimit të disqeve të shtypura në qendër duhet të montohet poshtë planit të buzës mbrojtëse.** Nëse disku nuk montohet siç duhet, duke dalë përtej planit të buzës mbrojtëse, nuk mund të mbrohet siç duhet.
- ▶ **Mbrojtësja duhet të fiksohet mirë te mjeti me korrent dhe të pozicionet për siguri maksimale, në mënyrë që disku të ekspozohet sa më pak drejt operatorit.** Mbrojtësja e ndihmon operatorin nga fragmentet e thyera të diskut, kontakti aksidental me diskun dhe shkëndijat që mund të bëjnë që rrobat të marrin flakë.
- ▶ **Disqet duhet të përdoren vetëm për punë specifike. Për shembull: mos fërkoni me pjesën anësore të diskut.** Disqet prerëse janë bërë për prerje anësore, ndaj forcat anësore që ushtrohen në këto disqe mund të bëjnë që ato të thyhen.
- ▶ **Përdorni gjithnjë flaxha disku të padëmtuara që kanë madhësinë dhe formën e duhur për diskun e caktuar.** Flaxhat e dhura të diskut e mbajnë mirë diskun duke pakësuar rrezikun e thyerjes së diskut. Flaxhat për disqet për prerje mund të jenë të ndryshme nga flaxhat e disqeve për fërkim..
- ▶ **Mos përdorni disqe të konsumuara që kanë mbetur nga mjetet e mëdha.** Një disk që është bërë për një mjet të madh nuk është i përshtatshëm për shpejtësinë më të lartë të një mjeti të vogël, ndaj mund të çahet.
- ▶ **Kur përdorni disqe rrotulluese për dy qëllime, përdorni gjithnjë mbrojtësen e duhur për punën që do të bëhet.** Nëse nuk përdoret mbrojtësja e duhur, mund të mos sigurohet mbrojtja e duhur, dhe kjo mund të shkaktojë lëndime fizike të rënda.

#### Paralajmërimet sigurie shtesë për punët e prerjes:

- ▶ **Mos e "bllokoni" diskun e prerjes ose mos ushtroni tepër presion. Mos u përpuni të bëni prerje tepër të thellë.** Sforcimi i tepërt i diskut rrit ngarkesën dhe rrezikun e përthyerjes ose bllokimit të diskut te vendi i prerjes, si dhe rrezikun e goditjes mbrapsht ose thyerjes së diskut.

- ▶ **Mos e poziciononi trupin në një drejtim mbrapa diskut të prerjes.** Kuir disku, në momentin e punimit, largohet nga trupi juaj, goditja e mundshme mbrapsht mund ta shtyjë diskut rrotullues dhe mjetin me korrent drejtpërdrejt te ju.
- ▶ **Kur disku bllokohet ose kur e ndaloni një punë prerjeje për çfarëdo arsyeje, fikeni mjetin me korrent dhe mbajeni palëvizur derisa disku të ndalojë plotësisht. Mos u përpiqni asnjëherë ta hiqni diskut nga vendi i prerjes ndërkohë që disku është në lëvizje, përndryshe mund të ndodhë goditje mbrapsht.** Kontrolloni dhe merrni masa korrigjuese për të eliminuar shkakun e bllokimit të diskut.
- ▶ **Mos e rifilloni punën e prerjes në material. Lërimi diskut të arrijë shpejtësi të plotë dhe futeni përsëri me kujdes te vendi i prerjes.** Disku mund të bllokohet, mund të dalë ose mund të godasë mbrapsht nëse mjeti me energji rindizet te materiali i punës.
- ▶ **Mbështetini panelet ose çdo material pune tepër të madh për të pakësuar rrezikun e kafshimit të diskut dhe goditjes mbrapsht.** Materialet e mëdha të punës kanë prirjen të marrin hark për shkak të peshës së tyre. Mbështetëset duhet të vendosen plotësisht poshtë materialit të punës pranë vijës së prerjes dhe pranë buzës së materialit në të dyja anët e diskut.
- ▶ **Bëni shumë kujdes kur bëni një "prerje xhepi" në muret ekzistuese ose në vende të tjera të verbra.** Disku që del mund të presë tubat e gazit ose të ujit, telat elektrikë ose objektet të cilët mund të shkaktojnë goditje mbrapsht.
- ▶ **Mos u përpiqni të bëni prerje me hark.** Sforcimi i tepërt i diskut rrit ngarkesën dhe rrezikun e përthyerjes ose bllokimit të diskut te vendi i prerjes, si dhe rrezikun e goditjes mbrapsht ose thyerjes së diskut, dhe kjo mund të shkaktojë lëndime fizike të rënda.

#### Paralajmërime sigurie specifike për punët e smerilimit:

- ▶ **Përdorni letër smerilimi me madhësi specifike. Ndiqni rekomandimet e prodhuesit kur zgjidhni letërën e smerilimit.** Letrat e mëdha të smerilimit që dalin përtej diskut mbështetës paraqesin rrezik çarjeje dhe mund të shkaktojnë bllokim, çarje të diskut ose goditje mbrapsht.

#### Paralajmërime sigurie specifike për punët e fërkimit:

- ▶ **Mbani parasysh se fijet e telit fluturojnë nga furça edhe gjatë punimit normal. Mos i sforconi telat duke ushtruar tepër forcë në furçë.** Fijet e telit mund të depërtojnë me lehtësi në rroba dhe/ose në lëkurë.
- ▶ **Nëse specifkohet përdorimi i një mbrojtëseje për fërkimin me furçë teli, mos lejoni asnjë pengesë të furçës e telit ose të furçës me mbrojtëse.** Disku i furçës së telit ose furçës mund të zgjerohet në diametër për shkak të ngarkesës dhe forcave centrifugale.

#### Informacione të mëtejshme sigurie



##### Mbani syze mbrojtëse.



**Mbrojtësja nuk duhet të përdoret për prerje.** Me një adaptor të përshtatshëm, mbrojtësja mund të përdoret edhe për prerje.



**Kapeni fort mjetin me të dyja duart dhe sigurohuni që t'i kenë pozicionuar mirë këmbët.** Mjeti me korrent mund të mbrohet më mirë me të dyja duart.

- ▶ **Për mjetet që kanë fileta të brendshme, si furçat dhe disqet e diamantit, duhet të tregohet kujdes lidhur me gjatësinë maksimale të fileteve të aksit.** Fundi i aksit nuk duhet të prekë bazën e mjetit.
- ▶ **Përdorni pajisje të përshtatshme kërkimi, për të gjetur linjat e fshehura të shërbimeve ose konsultohuni me kompaninë lokale të shërbimeve.** Kontakti me telat elektrikë mund të shkaktojë zjarr dhe goditje elektrike. Dëmtimi i një linje gazi mund të shkaktojë një shpërthim. Depërtimi në një linjë uji shkakton dëme materiale ose mund të shkaktojë goditje elektrike.
- ▶ **Mos i prekni disqet e fërkimit dhe prerjes derisa të jenë ftohur.** Disqet mund të nxehen shumë gjatë punës.
- ▶ **Lëshoni çelësin On/Off dhe vendoseni në pozicionin Off kur shkëputet energjia, p.sh. në rast se ka ndërprerje energjie ose kur hiqet spina e korrentit.** Kjo parandalon rindezjen e paqëllimshme.
- ▶ **Siguroni pjesën e punës.** Një pjesë pune e mbajtur në një kapëse ose vizë mbahet më mirë sesa me dorën tuaj.
- ▶ **Mbajeni mjetin brenda ndërtesave, në një dhomë të thatë, pa ngricë me temperaturë të njëtrajtshme.**
- ▶ **Hiqini mjetet e punës para se ta transportoni mjetin me korrent.** Kjo ndihmon për të shmangur dëmtimet.
- ▶ **Disqet e prerjes dhe fërkimit që janë të ngjitura kanë një datë skadimi, dhe pas kësaj date disqet nuk duhet të përdoren më.**

## Përshkrimi i produktit dhe shërbimit



**Lexoni të gjitha paralajmërimet dhe udhëzimet e sigurisë.** Mosrespektimi i paralajmërimeve dhe udhëzimeve të sigurisë mund të rezultojë në goditje elektrike, zjarr dhe/ose lëndime serioze.

Ju lutemi vini re ilustrimet në pjesën e përparme të udhëzimeve të përdorimit.

### Përdorimi në përputhje me qëllimin e duhur

Vegla elektrike është e destinuar për prerjen dhe pastrimin e materialeve të metalit, gurit, plastikës dhe të përbërë, për ashpërsimin e metaleve, plastikës dhe materialeve të përbëra dhe për shpimin e materialeve prej guri me shpime

diamanti pa përdorur ujë. Sigurohuni që të përdorni kapakun e duhur mbrojtës (shih "Funksionimi", Faqe 15).

Gjatë prerjes së gurit, siguroni nxjerrjen e duhur të pluhurit. Me mjetet bluarëse të miratuara, vegla elektrike mund të përdoret për lëmimin e letrës zmerile.

Vegla elektrike nuk duhet të përdoret për bluarjen e materialeve prej guri me rrota kupe diamanti.

## Komponentët e shfaqur

Numërimi i komponentëve të paraqitur i referohet paraqitjes së veglës elektrike në faqen grafike.

- (1) Leva e lëshimit për kapakun mbrojtës
- (2) Butoni i bllokimit të boshtit
- (3) Çelësi i ndezjes/fikjes
- (4) Dorezë shtesë kundër dridhjeve (sipërfaqja e izoluar e dorezës)<sup>a)</sup>
- (5) Dorezë shtesë standarde (sipërfaqja e izoluar e dorezës)
- (6) Grykë thithëse për smerilim<sup>a)</sup>
- (7) Kapak mbrojtës për bluarje
- (8) Kapak mbrojtës për ndarje<sup>a)</sup>
- (9) Mbulesa ndarëse
- (10) Filanxhë montimi me unazë O

- (11) Rrota e filxhanit karabit<sup>a)</sup>
- (12) Disk smerilues<sup>a)</sup>
- (13) Furça e diskut (Ø 22,22 mm)<sup>a)</sup>
- (14) Furça e diskut (M14)<sup>a)</sup>
- (15) Disk prerës<sup>a)</sup>
- (16) Disk prerës diamant<sup>a)</sup>
- (17) Dado shtrënguese
- (18) Dado shtrënguese e shpejtë **SDS-*cllic***<sup>a)</sup>
- (19) Çelës me dy vrima për dado shtrënguese/dado të rrumbullakët
- (20) Dorezë (sipërfaqja e izoluar e dorezës)
- (21) Bosht smerilimi
- (22) Mbrojtja e duarve<sup>a)</sup>
- (23) Shtresë lëmuese gome<sup>a)</sup>
- (24) Letër smeril<sup>a)</sup>
- (25) Dado e rrumbullakët<sup>a)</sup>
- (26) Furçë kupë<sup>a)</sup>
- (27) Furçë kon<sup>a)</sup>
- (28) Shpuese diamant<sup>a)</sup>
- (29) Çelës<sup>a)</sup>
- (30) Kapak thithje për ndarje me slitë udhëzuese<sup>a)</sup>

a) **Këto pajisje shtesë nuk janë pjesë e dorëzimeve standarde.**

## Të dhënat teknike

Gur fresibël me kënd		GWS 1400 C	GWS 1400	GWS 14-125
Numri i artikullit		<b>3 601 H24 2..</b>	<b>3 601 H24 8..</b>	<b>3 601 H24 8..</b>
Fuqia e vlerësuar hyrëse	W	1400	1400	1400
Fuqia dalëse	W	820	820	820
Shpejtësia e vlerësuar boshe <sup>A)</sup>	min <sup>-1</sup>	11800	11800	11800
Diametri maks. i diskut të lëmimit/shtresës lëmuese prej gome	mm	125	125	125
Shufër e boshtit të smerilimit		M 14	M 14	M 14
Gjatësia maks. e shufrës së boshtit të smerilimit	mm	22	22	22
Siguresë mbrojtëse		●	●	●
Fillim i butë		●	●	●
Elektronikë konstante		●	●	●
Pesha <sup>B)</sup>	kg	2,1	2,1	2,1
Klasa e mbrojtjes		□/II	□/II	□/II

A) Shpejtësia e vlerësuar e boshtit sipas EN IEC 62841-2-3 për zgjedhjen e mjeteve të përshatshme të aplikimit. Shpejtësia aktuale e boshtit nuk duhet të kalojë shpejtësinë e vlerësuar të boshtit dhe për këtë arsye është më e ulët.

B) Me mbulesë mbrojtëse (7), dorezë shtesë (5), filanxhë montimi (10) dhe dado shtrënguese (17), pa kablo energjie Informacioni vlen për një tension nominal [U] prej 230 V. Ky informacion mund të ndryshojë për tensione të ndryshme dhe versione specifike të vendit.

Vlerat mund të ndryshojnë sipas produktit dhe i nënshtrohen kushteve të aplikimit dhe mjedisit. Informacione të mëtejshme në [www.bosch-professional.com/wac](http://www.bosch-professional.com/wac).

## Informacion mbi zhurmën/dridhjet

Vlerat e emetimit të zhurmës përcaktohen në përputhje me **EN IEC 62841-2-3**.

Niveli i ponderuar i zhurmës A i veglës elektrike është zakonisht: Niveli i presionit të zërit **92 dB(A)**; Niveli i fuqisë së zërit **100 dB(A)**. Pasiguria K = **3 dB**.

**Mbani mbrojtje për veshët!**

Vlerat e dridhjeve  $a_h$  (dridhjet e vazhdueshme),  $p_f$  (dridhjet e përsëritura të goditjes) dhe pasiguria K e përcaktuar në përputhje me **EN IEC 62841-2-3**:

Bluarje sipërfaqësore (ashpërsim) dhe bluarje me prerje:

$$a_{h, AG/CO} = 5,6 \text{ m/s}^2 \text{ (K = 1,5 m/s}^2\text{)},$$

$$p_{F, AG/CO} = 314 \text{ m/s}^2 \text{ (K = 21 m/s}^2\text{)}$$

Smerilimi me disk smerilues:

$$a_{h, DS} = 4,5 \text{ m/s}^2 \text{ (K = 1,5 m/s}^2\text{)},$$

$$p_{F, DS} = 232 \text{ m/s}^2 \text{ (K = 14 m/s}^2\text{)}$$

Bluarja e fletëve të holla ose materialeve të tjera lehtësisht vibruese me një sipërfaqe të madhe mund të rezultojë në një vlerë të rritur të emetimit të zhurmës deri në 15 dB. Rritja e emetimeve të zhurmës mund të zvogëlohet duke përdorur dyshëkë të përshtatshëm amortizues të rëndë. Rritja e emetimeve të zhurmës duhet të merret parasysh si gjatë vlerësimit të rrezikut të performancës së zhurmës ashtu edhe gjatë zgjedhjes së mbrojtjes së përshtatshme të dëgjimit.

Niveli i dridhjeve dhe vlera e emetimit të zhurmës të dhëna në këto udhëzime janë matur sipas një metode matëse të standardizuar dhe mund të përdoren për të krahasuar veglat elektrike me njëra-tjetrën. Ato janë gjithashtu të përshtatshme për një vlerësim paraprak të emetimeve të dridhjeve dhe zhurmës.

Niveli i dhënë dridhjeve dhe vlera e emetimit të zhurmës përfaqësojnë aplikimet kryesore të veglës elektrike. Megjithatë, nëse vegla elektrik përdoret për përdorime të tjera, me mjete të ndryshme ose me mirëmbajtje të pamjaftueshme, niveli i dridhjeve dhe vlera e emetimit të zhurmës mund të ndryshojnë. Kjo mund të rrisë ndjeshëm emetimet e dridhjeve dhe zhurmës gjatë gjithë periudhës së punës.

Për një vlerësim të saktë të emetimeve të dridhjeve dhe zhurmës, duhet të merren parasysh edhe kohët kur pajisja është e fikur ose është në punë, por nuk është në përdorim. Kjo mund të reduktojë ndjeshëm emetimet e dridhjeve dhe zhurmës gjatë gjithë periudhës së punës.

Vendosni masa shtesë sigurie për të mbrojtur operatorin nga efektet e dridhjeve, të tilla si: mirëmbajtja e veglave dhe aksesorëve elektrikë, mbajtja e duarve të ngrohta, organizimi i proceseve të punës.

## Fillimi i butë

Fillimi i butë elektronik kufizon çift rrotullimet kur ndizet dhe mundësoni që vegla elektrike të fillojë pa probleme.

**Shënim:** Nëse vegla elektrike punon me shpejtësi të plotë menjëherë pas ndezjes, mbrojtja e rifilluar dhe fillimi i butë kanë dështuar. Vegla elektrik duhet të dërgohet menjëherë të shërbimi ndaj klientit; për adresat, shihni seksionin "Shërbimi ndaj klientit dhe këshilla për përdorim".

## Mbrojtja e rifilluar

Mbrojtja e rindezjes parandalon ndezjen e pakontrolluar të veglës elektrike pas një ndërprerjeje në furnizimin me energji elektrike.

